



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.5.2023

Nr: 458

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

**RAPORTIMIN FINANCIAR NË PLATFORMËN ELEKTRONIKE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (PERF)**  
**NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE TË**  
**DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 92/1, 92/2, 92/3 dhe 92/6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 15, datë 7.4.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Miratimin e kategorive të subjekteve zgjedhore që do të plotësojnë dhe dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, raportin financiar për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit financiar (PERF), si vijon:
  - a) Partitë politike/koalicionet të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore;
  - b) Kandidatët për Kryetar Bashkie që kandidojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.
2. Raporti financiar pasi ngarkohet në PERF nga partia politike/koalicioni, dorëzohet fizikisht në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i nënshkruar nga financieri dhe kryetari i partisë/personi i autorizuar prej tij.
3. Raporti financiar i kandidatit për kryetar bashkie pasi ngarkohet në PERF prej tij, dorëzohet fizikisht i nënshkruar tek financieri i partisë politike.

Data: 6.5.2023 Nr: 458  
Ora: 12:30



“Për raportimin financiar në platformën elektronike të raportimit financiar (PERF) nga subjektet zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

4. Raporti financiar i kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për Kryetar Bashkie, pasi ngarkohet në PERF, nënshkruhet dhe dorëzohet fizikisht në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve prej tij.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**